



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2023:258839

Datuma: 08.10.2024

Broj dokumenta: 06269773

K.nr.512/23

NE EMER TE POPULIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual **Siniša Borisavljević**, me bashkepunetoren profesionale **Pranvera Ismaili Zhinipotoku** dhe në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit B.P.nga Hajvalia, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 13.6, në lidhje me nenin 255, par.2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), më datë **05.08.2024** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B. P.**, i biri i H. i lindur më 05.03.1978 . në Prishtinë ,me vendbanim në Hajvali , rruga Padalisht nr.14 , K. Prishtinë ,ka të kryer shkollën e mesme , i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, e pa dënuar dhe nda jsaj nuk ka asnjë procedurë tjetër, nr i letërnjoftimit 1001171875 ,shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse :

Me datën rreth orës në rrugën Prishtinë-Gjilan Graqanicë në Graqanic ka ardhur deri të aksident trafiku si pasoj e pa kujdesis nga ana e shoferit të automjtit i cili gjatë drejtimit të automjetit si pasoj e mos respektimit të shenjës së trafikut shenja Stop del në rrugë kryesore dhe me pjesën e parme godet minibusin B në pjesën e pasme të anës së majt ku si pasoj shkaktohen dëme materiale si dhe lëndime trupore pesojn shoferi dhe pasagjeret në automjetin B ku pas tretmanit mjekësor të gjith lirohen në të njëjtën ditë

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 13.6 në lidhje me nenin 255 par.2 të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), së , për rrjedhojë gjykata duke vendosur në kuptim të nenit në fjalë si dhe

në bazë të neneve 3, 7, 8, 9, 13, 27, 29 dhe 35 të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ky Aktgjykim i shqiptohet të pandehurit ku:

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 240 € (dyqindekaterdhjeteuro), per vepren e kryer e cila i vihet ne barre si me larte.

Miratohet qe te paguhet gjoba ne dy keste të barabarta prej **120 euro** secila, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 10 € **(dhjete euro)** në afatin e njëjtë .

Nga një kopje të këtij Aktgjykimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës dhe te demtuarit.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJRKRR në F.Kosove, Gjykates i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr..... datë** kundër të pandehurit të lartëshenuar, për shkak të veprës kundërvajtëse e pershkruar sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, marrjes në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën-mbrojtjen e tij me dt 29.08.2024 , në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse , ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari muarr parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij , pranimin e fajsisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t’ a përsëris mënjë veprim të tillë si dhe faktin se deri me tani nuk ka qene i denuar , andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një denim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë denim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Ne baze të të gjitha te cekurave më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE
Departamenti i pergjithshem, Divizioni per kundervajtje
K.nr 512/23 nga 05.08.2024

Bashkepunetore Profesionale
Pranvera Ismaili Zhinipotoku

Gjyqtari
Siniša Borisavljević

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.